



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DEÇAN  
OPSTINA DEÇAN



## Kuvendi i Komunës – Deçan


Kuvendi i Komunës së Deçanit, bazuar në nenin 12, paragrafi. 12.1 dhe 12.2 pika (c dhe d), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr.28/2008), nenit 28 paragrafi 1 pika 3 të Statutit të Komunës së Deçanit 01.Nr.IX-5, dt. 31.10.2019, sipas Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.03.2023, miratoj këtë:

# RREGULLORE

## PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË DEÇANIT

Deçan, 2023

1



## **1.DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME**

### **Neni 1**

Më këtë Rregullore, përcaktohen procedurat, kushtet, kriteret për ndarjen e bursave, kohëzgjatja e realizimit të bursës, për studentë të studimeve themelore, në Universitet Publike në Republikën e Kosovës dhe Universitetet Publike jashtë Kosovës, formimi i komisionit dhe e drejta e ankesses.

### **Neni 2**

Komuna e Deçanit, çdo vite akademik, ndan bursa për studentë të Komunës së Deçanit.

### **Neni 3**

Kryetari i Komunës (në Këshillin e Drejtorëve) merr vendimin për shumën financiare për bursa që ndahen për një vit akademik, jo më pak se 400.00 Euro për një studentë.

### **Neni 4**

Lartësinë e bursës për studentë, behet duke respektuar minimumin e shumës sipas nenit 3, për studentët që i plotësojnë kushtet dhe kriteret e rregullorës për bursa.

### **Neni 5**

Komisionin për ndarjen e bursave për studentë e formon Asambleja Komunale, (katër anëtar nga asambleja komunale, një anëtarë nga zyra e kyetaritë, një anëtar nga DKA-ja, i cili përkujdeset për dosjet dhe gjithë procedurën e konkursit, nje anëtar nga shoqëria civile), duke respektuar barazinë gjinore.

### **Neni 6**

1.Drejtoria e Arsimit për çdo vit akademik, shpall konkursin për ndarjen e bursave.

2.Konkursi shpallen në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe në tabelën e shpalljeve. Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë, në raste të veqanta të paraqitura, komisioni mund të shty afatin e konkursit.

3.Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën pritëse Nr.1 në Komunën e Deçanit, më zarfë të mbyllur dhe duhet të jenë të protokoluara.

3. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

4.Drejtoria e Arsimit është e obliguar t'i kryejë të gjitha punët tekniko-administrative të domosdoshme dhe të nevojshme gjatë tërë procesit.

## KRITERET DHE PRIORITETET

### Neni 7

Fëmijët e dëshmorëve, të cilët janë studentë, më automatizëm do të jenë përfitues të bursës, ndërsa të tjerët do të ju nënshtrohen kritereve të shënuara si në vijim :

### Neni 8

Të drejtë për bursë komunale kanë studentët të cilët i plotësojnë këto kushte:

- Të jetë banor i Komunës së Deçanit (vendbanim të përhershëm);
- Të jetë student i rregullt në vitin akademik, në ndonjërin nga Universitetet Publike të Republikës së Kosovës dhe Universitetet Publike jashtë Kosovës
- Të jetë student i nivelit Bachelor;
- Të mos e ketë përsëritur (humbur) vitin akademik;
- Të jetë student i vitit të dytë e më lartë;
- Të kenë regjistruar vitin akademik për të cilin jepet bursa;
- Të kenë notë mesatare të studimeve së paku **8.5 (tetë pikë pesë)**
- Përjashtimisht nga pika 9 (nëntë) bëjnë pjesë studentët e :
  - a)Fakultetit Teknik;
  - b)Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, Departamenti i Matematikës dhe Departamenti i Fizikës, Departamenti i Kimisë;
  - c) Fakultetit i Mjekësisë;
  - d)Fakulteti i Arteve.

Studentët e këtyre lëmive të studimeve kanë të drejtë për bursë edhe me notë mesatare më të ulët se (8.5), por jo më pak se 7.5 (**shtatë pikë pesë**).

### Neni 9

Studentët e këtyre kategorive kanë bonus shtesë, prej (0.5 pikë) më tepër, në aspektin e notës mesatare, notë mesatare e përcaktuar në kriteret për bursë, sipas nenit 8 të kësaj rregulloreje si:

- 1.Personat me nevoja të veçanta;
- 2.Rastet sociale , gjendja e tyre ekonomike financiare;
- 3.Fëmijët e veteranëve, invalidëve dhe martirëve të luftës;
- 4.Studentët, prindërit e të cilëve kanë qenë të burgosur politik;
- 5.Studentët nga komunitetet;
- 6.Studentët që nuk i kanë prindërit, apo nuk jetojnë më prindër;
- 7.Studentët që vijnë nga familjet që kanë më shumë se dy studentë.

## **Neni 10**

Gjendja ekonomike financiare e familjes së studentit, vërtetohet sipas dëshmisë që e lëshon Qendra për Punë Sociale në Deçan, komisioni e ruan të drejtën të hulumtojë dhe të vërtetojë gjendjen e vërtetë ekonomike dhe financiare të kandidatit.

## **VLERËSIMI I KUSHTEVE DHE KRITEREVE**

### **Neni 11**

1.Pas përfundimit të afatit për konkurim, komisioni do të bëjë shqyrtimin e kërkesave, dhe do të hartojë listën përfundimtare të kandidatëve përfitues të bursës, në afatin 15 prej ditësh, gjithnjë duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë rregullore .  
2.Lista e përfituesve të bursës do të shpallet publikisht, dhe do të vendoset në tabelën e shpalljeve të Komunës së Deçanit, dhe në uebfaqen zyrtare të Komunës, të gjithë studentët aplikues do të njoftohen përmes emailit ose numrit të telefonit për listën fituese dhe të drejtën e ankesës.

## **ANKESAT**

### **Neni 12**

Komisionin për Ankesa e formon Asambleja Komunale, nga DKA-ja një zyrtar, dhe dy anëtar nga asambleja komunale.

### **Neni 13**

Kundër vendimit të komisionit për ndarjen e bursave komunale për student lejohet ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e shpalljes së listës së përfituesve të bursës, ankesa i drejtohet komisionit për ankesa.  
Vendimi i Komisionit për Ankesa është përfundimtar në procedurë admistrative, ndaj vendimit mund të inicohet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e njoftimit.

## **Neni 14**

- 1.Me studentë që e fitojnë bursën, lidhet kontratë.
2. Kontrata përpilohet nga DKA, e cila nënshkruhet nga përfituesi i bursës, Kryetari i Komunës dhe Drejtori i Arsimit.
- 3.Nëse brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e njoftimit të kandidatit, përfituesi i bursës, nuk e nënshkruan kontratën, kjo do të konsiderohet se ka hequr dorë nga bursa.
- 4.Me kontratë do të përcaktohet shuma dhe kohëzgjatja e dhënjës së bursës.

## **PROCEDURA E PAGESËS**

### **Neni 15**

- 1.Mjetet financiare do të alokohen në xhirrollogarinë e përfituesve të bursës, në ndonjë banke komerciale.
- 2.Drejtoria për Financa dhe Drejtoria e Arsimit janë të obliguara që të përkujdesen për alokimin e mjeteve të përfituara për bursë në afatin sa më të shkurtër kohor.

### **Neni 16**

Komisioni i bursave studentore dhe i ankesave votohen në të njëjtën ditë nga Kuvendi Komunal, në kërkesën e DKA-së për formimin e komisioneve. Antaret e komisioneve duhet të kompenzohen, sipas legjisllacioneve në fuqi.  
Drejtoria e Financave dhe e Arsimit përkujdesën për realizimin e kompenzimit të anëtareve të komisioneve të lartë cekura.

### **Neni 17**

Të dy komisionet pas përfundimit të procedurave të parapara më këtë rregullore, ju pushon mandati, dhe duhet të raportojnë para Kuvendit Komunal për punën e tyre.

## DISPOZITAT KALIMTARE - PËRFUNDIMTARE

### Neni 18

Zbatimin e kësaj rregulloreje nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës e bëjnë: Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

### Neni 19

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet të gjitha vendimet tjera.

### Neni 20

Kjo rregullore hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe pas publikimi në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.

## KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

01.Nr.III-5

Deçan,dt.30.03.2023

\_\_\_\_\_

Kryesuesi i Kuvendit  
Hajdar SUTAJ

